



Kosovar Center for Security Studies

The background of the cover is a solid blue color. At the top, there is a horizontal row of seven white, five-pointed stars. Below the stars, there is a faint, 3D-rendered bar chart with several vertical bars of varying heights. The overall aesthetic is clean and professional.

# Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë

Mars, 2014



Publikuar me mbështetjen e programit zyrtarë për  
zhvillim të Republikës Sllovaqe SlovakAid



# Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë

Mars, 2014

**Botues:** Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Autor:** Donika Emini

**Mentor:** Milan Nic

**Redaktimi i brendshëm:** Florian Qehaja

**Redaktimi i jashtëm:** Shpend Kursani

**Lekturimi gjuhësor në shqip:** Mentor Vrajolli

---

© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me Ligjin për të drejtat e autorit 2011/04-L-065

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë dhe përmes asnjë mjeti elektronik, mekanik apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga botuesi.

Pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe jo domosdoshmërisht shprehin pikëpamjet e Fondacionit PONTIS.

---

# PËRMBAJTJA

---

LISTA E SHKURTESAVE.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
HYRJE.....	8
METODOLOGJIA .....	8
<b>KORNIZA LIGJORE PËR PËRFSHIRJEN E MINORITETEVE NË KUADËR TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË.....</b>	<b>9</b>
Korniza Ligjore për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike: Vështrim i Përgjithshëm .....	9
Kuadri ligjor për mbrojtjen e pakicave etnike: Policia e Kosovës.....	10
Kuadri ligjor për mbrojtjen e pakicave etnike: FSK-ja .....	11
<b>PËRFSHIRJA E MINORITETEVE NË SEKTORIN E SIGURISË TË KOSOVËS: ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE .....</b>	<b>12</b>
Policia e Kosovës.....	12
Forca e Sigurisë e Kosovës.....	16
Këshilli i Sigurisë së Kosovës.....	19
<b>PERCEPTIMI I KOMUNITETEVE PAKICË NË INSTITUCIONET KOSOVARE TË SIGURISË .....</b>	<b>20</b>
Perceptimet: Policia e Kosovës .....	20
Perceptimet: Forca e Sigurisë së Kosovës .....	21
<b>KONKLUZION .....</b>	<b>23</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>24</b>
<b>ANEKSET .....</b>	<b>25</b>
A. KONVENTAT NDËRKOMBËTAR PËR FORCAT E ARTMATORUSA USHTARAKE .....	25
B. LIGJET NË SEKTORIN E SIGURISË QË RRJEDHIN NGA KUSHTETUTA TË MIRATUARA NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS .....	26
<b>BIBLIOGRAFIA .....</b>	<b>27</b>
Korniza ligjore.....	27
Reportet dhe Publikime .....	28
Intervista.....	30

---

## LISTA E SHKURTESAVE

---

<b>AKI</b>	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BRSH</b>	Brigada e Reagimit të Shpejtë
<b>FSK</b>	Forca e Sigurisë së Kosovës
<b>KTD</b>	Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës
<b>KSK</b>	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
<b>LFC</b>	Komanda e Forcës Tokësore
<b>MFSK</b>	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MUP</b>	Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë
<b>OECD</b>	Organizata për Siguri Bashkëpunim dhe Zhvillim
<b>OSB</b>	Brigada e Mbështetjes Operacionale
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>PSSP</b>	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën
<b>RSS</b>	Reforma e Sektorit të Sigurisë
<b>SKS</b>	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
<b>UÇK</b>	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
<b>ZÇK</b>	Zyra për Çështje të Komuniteteve

---

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Përfshirja e minoriteteve etnike në sektorin e sigurisë në Kosovë filloi menjëherë pas konfliktit. Me të filluar konsolidimi i institucioneve të sigurisë në Kosovë, korniza ligjore e nxjerrur në vitin 1999<sup>1</sup> krijoi edhe bazën institucionale për përfaqësimin proporcional të grupeve etnike. Më vonë këto rrethana tutje u mbështetën edhe nga Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës (Plani i Ahtisaarit<sup>2</sup>), i cili shërbeu si bazë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Të gjitha dispozitat e Planit të Ahtisaarit, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me përfshirjen e minoriteteve etnike në sektorin publik u bënë pjesë integrale të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (2008).

Tanimë që gjindemi disa vite pas shpalljes së pavarësisë, pjesëmarrja e minoriteteve etnike në Kosovë ka arritur një nivel relativisht të kënaqshëm, megjithëse edhe më tutje kohë dhe përpjekje për të garantuar konsistencë, sidomos brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Përkundër, progresit të arritur deri më sot, përfshirja e minoriteteve etnike në sektorin e sigurisë në Kosovë edhe më tutje mbetet çështje sfiduese. Përderisa vëmendje e madhe i është kushtuar integritimit dhe përfshirjes së pakicës serbe në sektorin e sigurisë në Kosovë, vëmendje më e vogël i kushtohet integritimit dhe përfshirjes së komuniteteve pakicave (jo) serbe në Kosovë. Sidomos, shqetësuese mbetet qasja e ulët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas (RAE) në institucionet e sigurisë e cila i atribuohet nivelit të ulët të arsimit, varfëria e theksuar dhe kushteve ekstreme në të cilat jetojnë këto komunitete.

---

<sup>1</sup> Sipas Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ( UNMIK)

<sup>2</sup> Për qëllime të këtij dokumenti të politikavedhe për ta mbajtur më të thjeshtë për lexuesin, ne do të referohemi vetëm me Planit Ahtisaari.

---

## HYRJE

---

Siguria në të gjitha dimensionet e saj është fundamentale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht për grupet etnike minoritare në Kosovë. Aspirata e Kosovës për integritet Euro-Atlantike ka qar drejt reformave të përgjithshme institucionale, prandaj, tek ne reformimi i sektorit të sigurisë (RSS), ndër të tjera, ka pasur për fokus të veçantë edhe inkuadrimin e grupeve etnike minoritare në sektorin e sigurisë (QKSS, 2012:77 – 78).

Kjo analizë ka për qëllim të avokoj tek institucionet e sigurisë së Kosovës dhe hartuesit e politikave. Gjithashtu, ky dokumenti i politikave ka për qëllim të kontribuojë në reformat aktuale të përgjithshme institucionale që i gjithë sektori i sigurisë në Kosovë po kalon duke synuar që të nxis edhe trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me përfshirjen e minoriteteve etnike në sektor të sigurisë. Audiencia dhe akterët kryesorë të këtij dokumenti janë institucionet e sigurisë në Kosovë, Qeveria e Kosovës, komunitetet etnike, përfaqësuesit e tyre dhe komuniteti ndërkombëtar i përfshirë në këtë proces. Po ashtu, ky punim ka për qëllim të ofrojë një kornizë analitike mbi gjendjen ekzistuese në lidhje me përfaqësimin dhe përfshirjen e minoriteteve etnike në sektorin e sigurisë në Kosovë.

### Metodologjia

Një shumëllojshmëri e gjerë e metodave të mbledhjes së të dhënave, kualitative dhe kuantitative, janë përdorur për qëllimet e përpilimit të këtij dokumenti. Metoda kualitative kryesisht është mbështetur në intervista sy-më-sy, si dhe në tre fokus grupe të realizuara me akterët kryesorë në lidhje me çështjet specifike në fushën e sigurisë. Gjithashtu, janë përdorur metoda të tjera kualitative, siç janë burimet e dorës së dytë apo të hulumtimit në zyrë, kryesisht për të mbështetur analizën e kornizës ligjore. Kjo analizë gjithashtu është mbështetur në gjetjet kuantitative të Barometrit Kosovar të Sigurisë, program ky në kuadër të QKSS-së i cili ka për qëllim matjen e perceptimeve të opinionit publik mbi politikat dhe institucionet e sigurisë në Kosovë.

Analiza fillon me një përshkrim të shkurtër për themelimin e institucioneve të sigurisë në Kosovë. Në këtë pjesë identifikohen akterët kryesorë të sektorit të sigurisë në Kosovë. Pjesa e dytë e analizës vazhdon duke ofruar një vlerësim të shkurtër kritik të kornizës aktuale ligjore në lidhje me përfshirjen e grupeve etnike minoritare në sektorin e sigurisë, si dhe po ashtu ekzistimi i mekanizmave dhe përgjegjësitë e tyre institucionale në përfshirjen e minoriteteve etnike. Pjesa e fundit e analizës ofron një vlerësim të gjendjes aktuale të përfshirjes dhe pjesëmarrjes së minoriteteve etnike në Policinë e Kosovës (PK), Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK) si dhe sfidat më të cilat këto institucione përballen në përmbushjen e kushteve të parapara me kornizën ligjore. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) është lënë jashtë kësaj analize për shkak të natyrës hermetike të këtij institucioni dhe kufizimet e ndryshme ligjore që e bëjnë të pamundur për të mbledhur informacion në lidhje me këtë institucion.



## KORNIZA LIGJORE PËR PËRFSHIRJEN E MINORITETEVE NË KUADËR TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË

### Korniza Ligjore për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike: Vështrim i Përgjithshëm

Legjislacioni në Kosovë garanton barazi në mes të gjitha grupeve etnike minoritare që jetojnë në Kosovë, si dhe promovon të drejtat individuale të njeriut, përfshirë ato që i dedikohen personelit të uniformuar apo atij civil. Duke pasur parasysh faktin që Kushtetuta e definon Kosovës si shtet multietnik, dhe legjislacioni primarë i sigurisë në Kosovë më tej definon përbërjen etnike (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008: Art 125). Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sektorin e sigurisë pasi që ky sektor siguron unitetin dhe kohezionin nacional.

Në teori, korniza ligjore e Kosovës mëton të jenë në përputhje me po thuajse të gjitha praktikatat më të mira ndërkombëtare sa i përket sa i përket përfaqësimit institucional të komuniteteve etnike përfshirë edhe në sektorin e sigurisë (OSBE, 2012: 8-9). Kushtetuta e Republikës së Kosovës përfshin të gjitha garancitë e nevojshme njerëzore për minoritetet etnike, po ashtu të gjitha ligjet dhe rregulloret në Kosovën e paspavarësisë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me fushën e integritetit të komuniteteve, kanë marrë parasysh praktikatat dhe modelet më të mira në fushën e të drejtave të njeriut. Për shembull, korniza ligjore e Kosovës ka miratuar dispozitat nga Deklarata Univerzale për të Drejtat e Njeriut (UDHR, 1948: Neni 2), Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR 1966: Art 26, 27), si dhe Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (ECHR, 1966: Art 1, 24). Kjo ka krijuar një bazë të mirë ligjore për përfshirjen e grupeve etnike minoritare në institucionet e Kosovës (Shih Shtojcën A).

Në kuadër të legjislacionit të Kosovës, ekzistojnë disa ligje të cilat drejtpërsëdrejti trajtojnë mbrojtjen e të drejtave komuniteteve pakicë në vend. Për shembull, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDKP Nr 03/L-047)<sup>3</sup> miratuar më 13 mars 2008 shprehimisht vendos dispozitat e përgjithshme mbi të drejtat e minoriteteve, në mënyrë që të sigurohet barazi e plotë dhe efektive për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Ky ligj gjithashtu, siguron dhe garanton mbrojtjen e identitetit, kulturës, fesë, qasjen në arsim, kujdes shëndetësor, si dhe pjesëmarrjen e plotë politike dhe publike të grupeve etnike minoritare. Po ashtu, nëpërmjet këtij ligji sigurohet

<sup>3</sup> Aprovuar në bazë të Nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

pjesëmarrja politike e komuniteteve etnike pakicë në dy nivele në atë lokal dhe nacional. Si rrjedhojë, ky ligj vendos bazat për krijimin e **Këshillit Konsultativ për Komunitete** me qëllim të koordinimit dhe konsultimit për të gjitha komunitetet në Kosovë. Në anën tjetër, **Ligji për Përdorimin e Gjuhëve** miratuar më 26 korrik 2007 vendosi përdorimin e gjuhën Shqipe dhe Serbe si dy gjuhët zyrtare në nivel kombëtar, si dhe parasheh po ashtu rregullon kushte në bazë të së cilave edhe gjuhët e tjera, si ajo turke, boshnjake dhe rome do mund të përdoshin në mënyre zyrtare goftë në nivelin komunal, ose në nivel nacional (LPGJ nr 02/L-37:Neni 1). Po ashtu, **Ligji Kundër Diskriminimit** miratuar më 19 shkurt 2004 (Ligji Nr.2004/3) është një dokument tjetër ligjor i cili mbron minoritetet etnike nga çdo lloj diskriminimi, kur është fjala për zhvillimin e karrierës së tyre dhe qasje në vende të punës (LKD 2004/3, Art 2).

Një tjetër ligj i cili kishte për qëllim në radhë të pare avancimin e pozitës së lomuniteteve pakicë ishte edhe **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** (Ligji nr 03/L-049) i cili u miratua më 20 shkurt 2008. Në veçanti, nxjerrja e këtij ligji kishte synim garantimin e një pozite të kënaqme dominuese në nivelin për komunitetin lokal Serb i cili jeton në Kosovë duke ju dhenë kompetenca shtesë komunave ku ata përbëjnë shumicë (LVL 2008: Neni 23).

## Kuadri ligjor për mbrojtjen e pakicave etnike: Policia e Kosovës

Mandati i Policisë së Kosovës (PK) sa i përket përbërjes së saj etnike definuar që me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 128 i Kushtetutës së Kosovës përcakton qartë strukturën e PK-së dhe thekson se: "Policia është profesioniste dhe pasqyron shumëllojshmërinë etnike të qytetarëve të Republikës së Kosovës"(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008: Neni 128/2). Përveç kësaj, **Ligji për Policinë**, miratuar më 2 mars 2012 (Ligji nr. 04/L-076) përfshin dispozita specifike që garantojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë të minoriteteve etnike në strukturat e PK-së.

Neni 35 i këtij ligji mbi stacionet lokale të policisë potencon se "përbërja etnike e zyrtarëve policorë të caktuar në kuadër të komunave të caktuar duhet që, brenda mundësive, të pasqyrojë shumëllojshmërinë etnike brenda komunës përkatëse" (LP 03/L-076:Neni35). Gjithashtu, neni 41 i po të njejtij ligji (që trajton Komandantët e Stacioneve) thekson faktin se komandantët e stacioneve "në komunat ku komuniteti më i madh etnik është serb, përzgjedhja nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të PK e komandantëve të stacionit si dhe komandantëve të nënstacioneve policore duhet të bëhet me pjesëmarrje të Kuvendeve Komunale"(LP 03/L-076: Neni41).

Për më tepër, tashmë ekzistojnë edhe garanci të tjera që vijnë si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit të 19 prillit 2013, në mes të Kosovës dhe Serbisë ku trajtohet edhe çështja e përbërjes së PK në pjesën veriore të Kosovës. Më specifikisht, pika 7, 8 dhe 9 të marrëveshjes trajtojnë specifikisht elemente që kanë të bëjnë me strukturën së Policisë atje. Marrëveshja në mënyrë të qartë thekson se pjesëtarët e strukturave paralele në pjesën veriore të Kosovës duhet të integrohen në strukturat Kosovare të sigurisë, përshtirë edhe në Policinë e Kosovës, si dhe kjo e fundit duhet të jetë e vetmja forcë policore e cila operon në

Kosovë. Për të siguruar integrimin e plotë të komunitetit serb në pjesën veriore të Kosovës, një pikë e veçantë është rezervuar për Komandantin Rajonal të Policisë në katër komunat e veriut me shumicë serbe<sup>4</sup>. Ngjashmërisht me komunat tjera, përbërja e PK-së në veri duhet të pasqyrojë përbërjen etnike të popullatës në atë komunë. Mendohet po ashtu që marrëveshja edhe komandanti rajonal i PK në Veri të jetë një serb i Kosovës i cili duhet miratuar nga MPB e nominuar nga katër kryetarët e komunave në emër të Komunitetit/Asociacionet (Marrëveshja Kosovë - Serbi 2013:Pika 7,8 dhe 9). Kjo temë do të zgjerohet më tej në sesionet e ardhshme mbi gjendjen reale në lidhje me përfshirjen e minoriteteve në PK.

## Kuadri ligjor për mbrojtjen e pakicave etnike: FSK-ja

Pas shpalljes së pavarësisë, Kosova themloi FSK-në së bashku me Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK). Baza ligjore për krijimin e FSK dhe MFSK-së ishte vendosur në mënyrë të qartë në Planin e Ahtisaarit<sup>5</sup> e që u inkorporua edhe në Kushtetutë dhe ligj. Kushtetuta e Kosovës, saktëson se FSK “duhet të mbrojë qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj”, dhe që “FSK-ja duhet të pasqyrojë shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës”(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008: Neni 126/2-4)

Në anën tjetër, **Ligji për FSK**, i miratuar më 13 Qershor 2008 (Ligji nr 03/L-046) në mënyrë eksplicite thekson se FSK është një forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë pavarësisht përkatësisë etnike dhe fetare (LFSK 03/L-046,2008:Neni9). Përfshirja e minoriteteve në FSK gjithashtu është e rregulluar me **Ligjin për Shërbimin në FSK** i miratuar më 13 Qershor 2008 (Ligji nr 03/L-082), sipas këtij ligji çdo anëtar i kësaj force duhet të trajtohet në mënyrë të drejtë pa asnjë diskriminim në baza etnike apo gjinore (Ligji për Shërbimin në FSK 2008:Neni3). Në bazë të këtij ligji si dhe strategjisë së burimeve njerëzore dhe politikave të rekrutimit në këtë forcë, një kuotë prej 10% është krijuar për t’u plotësuar nga minoritetet etnike që jetojnë në Kosovë<sup>6</sup>. Duke pasur parasysh që ky ligj qartësisht definon përfshirjen etnike brenda forcës, ky ligj gjithashtu parasheh që dy gjuhët zyrtare të forcës duhet të jenë gjuha Shqipe dhe Serbe. Në raport dhe komunikim me organizatat ndërkombëtare mund të përdoret edhe gjuha Angleze (03/L-046, 2008: Neni 9). Po ashtu, është me rëndësi të përmendet edhe Ligji për themelimin e MFSK-së, organ ky qeverisës i cili është i përbërë nga një strukturë e integruar e zyrëtarëve (60%) civil dhe (40%) të uniformuar (Qehaja F., Vrajolli, M. 2012: 30).

Sesioni i ardhshëm do të analizojë dhe elaborojë situatën aktuale si dhe sfidat e zbatimit të ligjeve të lartë-përmendura, si dhe strategjitë e rregulloret. Siç u potencua në fillim të këtij dokumenti të politikave fokusi kryesor do të jetë në PK, FSK dhe KSK.

<sup>4</sup> Komuna e Mitrovicës së Veriut, Zvecanit, Zubin Potokut dhe Leposavicit

<sup>5</sup> Gjithashtu e miratuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në Qershor 2008

<sup>6</sup> Intervistë me zyrtarë të MFSK-së

---

## PËRFSHIRJA E MINORITETEVE NË SEKTORIN E SIGURISË TË KOSOVËS: ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE

---

### Policia e Kosovës

Është e qartë se korniza e përgjithshme ligjore, si dhe ato që kanë të bëjnë me Policinë e Kosovës sigurojnë mbrojtje adekuatë si dhe përfshirjen të barabartë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në territorin e një komune të caktuar. Përderisa disa komuna<sup>7</sup> e kanë zhvilluar mirë strategjinë për arritjen e këtyre qëllimeve, të tjerat ende nuk kanë arritur të sigurojnë përfaqësim të drejtë (OSBE, 2009: 3).

Policia e Kosovës vepron nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe përbëhet prej rreth 7,527 zyrtarë policorë dhe 1143 staf civil (Intervistë me zyrtarë të PK-së, 2014). Raporti në mes numrit të zyrtarëve policor dhe popullatës në Kosovë është përafërsisht 1 me 245,21 që konsiderohet të jetë i ngjashëm me vendet e tjera evropiane<sup>8</sup>. Ndërkohë, Policia e Kosovës është duke punuar vazhdimisht në lidhje me ruajtjen e diversitetit etnik të saj në pajtim me atë që është paracaktuar me ligj. Kështu, pavarësisht sfidave, PK-ja konsiderohet të jetë "kryesues" në këtë drejtim, në raport me institucionet tjera të sigurisë në Kosovë. Që nga themelimi i saj, PK-ja ka arritur një nivel të kënaqshëm të pjesëmarrjes së minoriteteve etnike, në veçanti, përfshirjen dhe integrimin e pakicës serbe në Kosovë, siç tregohet në tabelën 1.

Sipas statistikave të PK-së, ky institucion ka një performancë përgjithësisht të mirë, kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfshirjen e minoriteve etnike brenda këtij institucioni. Këtë tregojnë edhe statistikat, ku në fund të vitit 2013, vetëm rreth 84.22% të stafit të PK-së kanë qenë shqiptarë, ndërsa 11.49% ishin serbë, si dhe rreth 5% kanë qenë anëtarë të grupeve të tjera etnike (Intervistë me zyrtarët e PK-së, më 2014).

---

<sup>7</sup> Përfshija duhet të jetë në përputhje me përbërjen etnike, prandaj edhe mbetet kompetencë e nivelit lokal.

<sup>8</sup> Bazuar në Statistika, Kosova qëndron ngjashmërisht me Turqinë, Shqipërinë, Moldavinë, Austrinë, Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Sloveninë dhe Greqinë

<b>TABELA 1: KOMPOZICIONI ETNIK BRENDA POLICISË SË KOSOVËS (STAFI I UNIFORMUAR DHE CIVIL)</b>		
Statistikat në bazë etnike (PK- SO - CIV)	Totali	Total i në%
Shqiptarë	7,302	84.22%
Serb	996	11.49%
Bosnjak	205	2.36%
Turk	73	0.84%
Rom	15	0.17%
Egjiptian	7	0.08%
Ashkali	20	0.23%
Goran	40	0.46%
Të tjerët	12	0.15%
<b>Totali</b>	<b>8,670</b>	<b>99.87%</b>

<b>TABELA 2: KOMPOZICIONI ETNIK BRENDA POLICISË SË KOSOVËS (STAFI I UNIFORMUAR)</b>		
Statistikat Etnike Brenda PK (Stafi i Uniformuar)	Totali	Totali në %
Shqiptarë	6,280	83.43%
Serb	904	12.01%
Boshnjak	191	2.53%
Turk	67	0.89%
Rom	14	0.18%
Egjiptian	7	0.09%
Ashkali	19	0.25%
Goran	36	0.47%
Të tjerët	9	0.11%
<b>Totali</b>	<b>7,527</b>	<b>100%</b>

**TABELA 3: KOMPOZICIONI ETNIK BRENDA POLICISË SË KOSOVËS (STAFI CIVIL)**

Statistikat Etnike Brenda PK (Stafi Civil)	Totali	Totali në %
Shqiptarë	1022	89.41%
Serb	92	8.04%
Boshnjak	14	1.60%
Turk	6	0.52%
Rom	1	0.08%
Egjiptian	0	0.00%
Ashkali	1	0.08%
Goran	4	0.34%
Të tjerë	3	0.26%
<b>Totali</b>	<b>1143</b>	<b>100%</b>

Për këtë nivel kaq të knaqshëm të përfaqësimit jo rrallë herë PK ka marrë lavdata edhe komuniteti ndërkombëtarë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me minoritetin serb, duke shëndërruar PK-në, në një institucion model jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon dhe Evropë (GNK, Raporti Evropian 2009:p 13). Përkundër, arritjes aktuale të rezultateve të kënaqshme, procesi i përfshirjes së minoriteteve nuk ka kaluar pa sfida dhe vështirësi. Nëse kjo çështje analizohet nga këndvështrimi politik, PK-ja ka qenë vazhdimisht e sfiduar kur kemi të bëjmë ne ruajtjen e kuotave të saja me pjestarë të komunitetit serb, të cilët fillimisht pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 kishim kërcënuar me bojkotimin e PK-së. Shkaktarë kryesor për këtë bojkot në masë të madhe ishte presionit konstant politik nga zyrtarët e Beogradit. Në fakt, pët shkak se numri i atyre që bojkotuan këtë institucion ishte relativisht i madh, Qeveria e Kosovës në koordinim me EULEX-in u detyrua që të vendoste afat përfundimtar për kthimin e tyre në pozitat e tyre të më hershme në kuadër të PK jo më larg se në qershorin e 2009. Kjo strategji kishte dha rezultate pozitiv, pasi që shumica e zyrtarëve policor serbë u kthyen me të kuptuar se ata do të mund humbasin punët e tyre dhe se Serbia nuk mund të mbështesë financiarisht ata (GNK Raporti Evropian, 2009:14).

Kështu, edhe tashmë më ne vitin 2013, PK-ja konsiderohet të jetë një institucion lider sa i përket diversitetit etnik, qoftë me pjesëtarë të komunitetit Serbë apo minoritete të tjera, dhe atë në të gjitha nivelet, duke gëzuar një reputacion të kënaqshëm për ndershmëri në kryerjen e punëve të saj (ICG 2012: 6-7). Diversiteti i përbërjes etnike në PK është pranuar mirë edhe nga qytetarët. Si rezultat, shumë do të binin dakord që ky fakt solli qëndrueshmëri, konsistencë dhe respekt brenda forcës, veçanërisht në zonat kryesisht të banuara nga këto grupe minoritare. Madje, ka të tillë që argumentojnë se të qenurit një institucion multi-etnik me pjestarë të komuniteti përbërëse brenda komunave përkatëse ka lehtësuar dukshëm ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërmjet zyrëtarëve policor dhe popullsisë lokale.

Vlen të theksohet se bashkëpunim tepër të mirë ka edhe në mes të zyrtarëve të policisë të komuniteteve të ndryshme etnike. Meritore për këtë, është edhe organizimi i kurseve të detyrueshme për dygjuhësi (Shqip dhe Serbisht) për të gjithë të gjithë te rekruturari

e PK-së gje që me pas ka rezultuar në përmirësim të bashkëpunim ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme në të gjitha nivelet brenda kësaj force (Focus Group 2014).

Ndryshe nga pjesa jugore e Kosovës, përfshirja e komunitetit serb në pjesën veriore të Kosovës në PK mbeti një sfidë pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 deri në Marrëveshjen e Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë në prill 2013. Gjatë tërë kësaj periudhe, zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë qenë më të përgjegjshëm kundrejt Beogradit se sa Prishtinës. Zyrtarët Serb në veri të Kosovës kanë raportuar në Prishtinë vetëm me ndërmjetësimin e EU-LEX-it, e cila gjithashtu kishte një qasje të kufizuar gjatë kësaj periudhe (ICG 2011:2-3). Beogradit ka mbajtur MUP-in, BIA-n, si dhe struktura të tjera të sigurisë gjatë gjithë kësaj periudhe. Megjithatë, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së parë në Bruksel, integrimi gradual i policëve të Policisë së Kosovës dhe ish-strukturave të MUP-it Serb që punojnë në veri ka filluar. Stacionet e policisë që kanë operuar në pjesën veriore të Kosovës janë mbyllur tashmë, ndërsa pagat nga Serbia janë ndaluar, gjykatat serbe kanë ndaluar punën, si dhe kuvendet komunale në katër komunitat veriore janë shpërbërë (KE, 2013:1). Në përputhje me Marrëveshjen e parë në Bruksel, rreth 300 ish-pjesëtarë të MUP-it Serb pritet që të bëhen pjesë e PK-së, ndërsa aplikimi i kriterëve të rekrutimit që është duke u aplikuar për ish-pjesëtarët e MUP-it, ende mbetet e diskutueshme në mesin e të dy komuniteteve, atë Shqiptarë dhe Serb që jetojnë në Kosovë (Kosova Press, 2013). Hapat e “përshpejtuar” të procesit të rekrutimit dhe nënshkrimit të kontratave të punësimit në mes të Policisë së Kosovës dhe ish-pjesëtarët e MUP-it nuk është parë si një proces i drejtë dhe i hapur (Focus Group , 2013).

Sipas të dhënave të fundit të lansuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën (PSSP), rreth 80 ish policë serbë kishin përfunduar tranzicionin e tyre në PK, më vonë ky numër është rritur dhe ka arritur në një total prej 142 oficerëve, pjesëtarë që tashmë janë caktuar për detyrë aktive në komandën rajonale veriore. Pritet që rreth 100 oficerë shtesë të përfundojnë induksionin e tyre dhe së shpejti të marrin detyrat në Veri (PSSP, 2014:1). Prosesi i rekrutimit të ish-pjesëtarëve të MUP-it është ende në vazhdim. Prosesi i tyre i integritimit është parë pozitivisht nga të dy qeveritë (Kosovës dhe Serbisë) si dhe nga komuniteti ndërkombëtar, duke lënë të kuptohet se kjo do të sigurojë vendosjen e plotë të sundimit të ligjit në pjesën veriore të Kosovës (KFOR 2014). Rekrutimi dhe integrimi i ish-pjesëtarëve të MUP-it, në PK është duke u pranuar me entuziazëm sidomos në Prishtinë dhe nga akterët e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, sepse ky proces do të siguronte kontrollin e Prishtinës mbi pjesën veriore të Kosovës, ndoshta për herë të parë pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.

Në anën tjetër, përderisa vëmendje e madhe i është kushtuar integrimint dhe përfshirjes së komunitetit Serb në PK, integrimi dhe përfshirja e komuniteteve të tjera jo-shqiptare në Kosovë, veçanërisht Romë, Egjiptian dhe Ashkali si dhe qasja e tyre në institucionet e sigurisë është në nivel shqetësues. Qasja e ulet në arsim është një faktor vendimtar në mënyrë që të vazhdohet me hapa të tjerë të rekrutimit në institucionet e sigurisë, prandaj, siç do të elaborohet në seksionin tjetër këto grupe shumë pak të përfaqësuara në institucionet e sigurisë në përgjithësi.

Për më tepër, pasi që nuk ekziston sistemi i kuotave brenda PK-së për të rritur përfaqësimin e komuniteteve jo-shqiptare, për shkak të mundesës që kualiteteve të duhura të kandi-

datëve, shumë gjenerata të policisë kanë diplomuar me një numër shumë të ulët të kadetëve nga grupet e tjera etnike dhe shumë shpesh rekrutimi si dhe diplomimi përfundoi me zero pjesëtarë të këtyre tri komuniteteve. Pavarësisht nga fakti se këto grupe janë lënë mënjanë për shkak të nivelit të dobët të edukimit, gjithashtu mungesa e burimeve të informacionit konsiderohet si një faktorë tjetër që ndikon në nivelin e ulët të integritimit në PK. Përderisa shumica e kriterëve të rekrutimit të PK janë kryesisht të lidhura me njohuritë rreth, legjislacionit social dhe në lidhje me situatën e sigurisë në Kosovë, pjestarët e këtyre grupeve posedojnë informacion të kufizuar mbi sigurinë për shkak të mungesës së gazetave lokale dhe mediave elektronike ose burime të tjera në gjuhën amtare.

Kosova ka një numër të konsiderueshëm të lagjeve me popullsi nga këto komunitete. Për të ndërtuar besimin dhe përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike në mesin e këtyre komuniteteve me PK, një numër adekuat i policëve nga këto komunitete duhet të jenë të punësuar në kuadër të PK-së për Policim në Komunitet. Në këtë drejtim, organizimi i një trajnimi specifik përgatitorë për komunitetet tjera me fokus tek aplikantët Rom, Egjiptian dhe Ashkali në PK, është duke u planifikuar me qëllim të parapërgaditjes së tyre për testin e pranimit në PK. Gjithashtu, OSBE-ja në bashkëpunim me PK do të ndërmarrë një fushatë vetëdijësimi për komunitetet tjera, duke u fokusuar në Rom, Egjiptian dhe Ashkali në Kosovë për të zgjeruar njohuritë e tyre në lidhje me çështjet e sigurisë në lidhje me lagjet e tyre. (Muharremi 2014).

## Forca e Sigurisë e Kosovës

Përfaqësimi i grupeve etnike minoritare në kuadër të FSK-së është më i ulët krahasuar me përfaqësimin e tyre në PK. Megjithatë, kohët e fundit, pjesëmarrja e komuniteteve etnike në Kosovë në përgjithësi është në rritje dhe kjo është duke u reflektuar edhe në kuadër të FSK-së. Përfshirja e komunitetit Serb në kuadër të FSK-së ka qenë mjaftë e kufizuar, dhe mungesa e motivimit të këtij komuniteti për t'u bashkuar me këtë institucion është i lidhur ngushtë me faktorët politik.

Pavarësisht nga faktit se qasja e barabartë për të gjitha etnitetet brenda FSK-së në Kosovë garantohet me kornizë aktuale ligjore të Kosovës (Kushtetuta dhe ligjet e tjera), pjesëmarrja dhe përfshirja e komunitetit Serb në veçanti, ka qenë sfiduese dhe njëra ndër proceset më të vështira në kuadër të FSK-së (QKSS dhe FIQ, 2011:13). Megjithatë, bashkarisht MFSK dhe FSK-ja janë duke bërë përpjekje në mënyrë të vazhdueshme për të inkurajuar pjesëmarrjen e të gjitha grupeve etnike në Kosovë.

Për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të të gjitha minoriteteve etnike, MFSK dhe FSK në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunojnë edhe me Zyrën për Çështje të Komuniteteve (ZÇK)<sup>9</sup> një trup qeveritar i krijuar për të shërbyer si një pikë referuese për çështjet e komuniteteve në kuadër të Qeverisë së Kosovës- Zyrës së Kryeministrit. Detyra e ZÇK-së është që të kontribuojë në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të FSK-së, në promovimin e lartë të standardeve dhe respektimit të drejtave e anëtarëve nga të gjitha minoritetet etnike (FSK, 2010:21).

<sup>9</sup> Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK), e krijuar me vendimin e Kabinetit Nr. 06/34 mbi krijimin e Zyrës, më 3 shtator 2008



Numri i anëtarëve aktiv brenda FSK-së ka arritur në 2.294 (Syla 2014) dhe sipas të dhënave të FSK-së, gjatë vitit 2013 përqindja e minoriteteve etnike në kuadër të FSK-së ka arritur deri në 8,85% (FSK, 2012:15). Në krahasim me PK, përfaqësimi i pakicave etnike në kuadër të FSK-së mbetet ende i ulët, sidomos kur flitet për komunitetin Serb, i cili përfaqësohet me vetëm në rreth 1.83% të personelit të punësuar në nivel të përgjithshëm të uniformuar.

**TABELA 4: KOMPOZICIONI ETNIK BRENDA FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Statistikat Etnike brend FSK	Totali	Totali në %
Shqiptarë	2,091	91.15%
Serb	42	1.83%
Turk	55	2.40 %
Boshnjak	49	2.14%
Ashkali	29	1.26%
Egjiptian	19	0.83%
Rom	3	0.13%
Goran	2	0.09%
Others	3	0.26%
<b>Totali</b>	<b>2,290</b>	<b>99.83%</b>

**TABELA 5: KOMPOZICIONI I FSK NË VITIN 2013**

Numri i përgjithshëm i personelit të MFSK/FSK	Struktura	Të lira	Të plotësuar	Totali Minoritete	
MFSK	CIVIL	134	2	132	8
	USHTARAK	68	7	61	0
KFT	CIVIL	100	6	94	1
	USHTARAK	245	16	229	8
BMO		808	45	763	49
BRSH		1,122	105	1,017	132
KDS		194	6	188	15
Zyrtarë të pa-sistemuar		63	0	5	
Totali i Personelit		2,500	179	2,263	204
Uniformuar(%)		100%	7.16%	90.52%	9.01%
Civil në MFSK		234	8	226	9
Civil(%)		100%	3%	97%	4%
RESERVË		800	322	478	10
(%)		100%	40%	60%	2%
Cadet in QSU			39	1	
Totali i USHT/C		3534	509	3005	224
<b>Totali në %</b>	<b>100%</b>	<b>9%</b>	<b>91%</b>	<b>7.45%</b>	

Që nga themelimi i FSK-së, minoriteti Serb ka pasur qasje kryesisht negative ndaj kesaj force. Si duket, për ta FSK ka qenë ngushësishti lidhur me statusin e Kosovës, andaj, komuniteti Serbe shumë pak ka treguar interesim për t'u bërë pjesë e forcës. Presionet politike i ushtruar nga Beogradi si dhe nga grupet radikale brenda Kosovës mbi vet Serbët lokal ka dëmtuar procesin e përfshirjes së minoriteteve në forcë. Për më tepër, tek komuniteti Serb FSK edhe më tutje mbetet institucion jopopullor, jo vetëm për shkak të identifikimit të saj me shtetin e Kosovoës (Fokus Group, 2014) por gjithashtu edhe për faktin se për shumicën e tyre FSK paraqet një derivativ të dalur nga Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) e cila luftoi kundër forcave serbe në fund të viteve të 90-ta. Kjo është për arsye se kur UÇK-ja si forcë u shpërbë pas luftës, shumica e anëtarëve të saj u rekrutuan nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), e cila shërbeu si një trupë e cila kishte për qëllim reagimet emergjente civil humanitar. Si do qoftë, pas shpërbërjes së kësaj Trupe në 2009, një pjesë e konsiderueshme e pjesëtarëve të saj zyrtarisht ju bashkuan FSK-së e cila ishte posathemeluar, gjë po përdoret si argument nga nje pjesë e minoritetit etnik serb, që të ndërlihdin ish-UÇK-së me FSK- në e sotme.

Megjithë sfidat politike te përmendura, vlenë të përmendet se në anën tjetër janë bërë edhe disa lehtësi kryesore të cilat kanë pasur për qëllim facilitimin minoriteteve etnike në FSK. Për shembull, ndryshe nga PK, ku përdorimi i të dy gjuhëve nga ana e pjesëtarëve të saj, pra, Shqipe dhe Serbe në nivel bazik është e obligueshme, në FSK nuk është obligative që pjesëtarët e komunitetit Serb të mësojnë gjuhën shqipe dhe e kundërta. Përderisa, përdorimi i dy gjuhëve është i mundshëm në komunikim të përditshëm në nivel zyrtarë, e njëjta gjë është pothuajse e pamundur të ndodh gjatë kryerjes së operacioneve apo nivelet e tjera të komunikimit. Kurset për gjuhën Shqipe dhe Serbe për anëtarët e kësaj force janë lansuar tashmë, por, këto kurse janë vetëm zgjedhore dhe jo të detyrueshme, sikur ka ndodhur në rastin e PK-së (Focus Group, 2014). Për të qenë të saktë, projekti i kurseve të gjuhëve është futur së fundmi në kuadër të FSK-së dhe vetëm një grup i vogël prej 30 persona kanë shprehur interesim për të ndjekur kursete ofruara.

Megjithatë, përpjekjet e FSK-së dhe fushatat konstante në rajonet e banuara nga minoriteti etnik serb kanë sjellë një rezultat pozitiv. Është shënuar një rritje e interesimit nga gurpet minoritare, sidomos nga serbët që jetojnë në Kosovë, megjithatë, faktorët politikë të përmendur më parë ende mbeten një sfidë. Ndikimii madh nga qarqet radikale në mesin e serbëve dhe zyrtarëve të Beogradit në njerëzit e afërt të tyre në Kosovë vazhdon të jetë një pengesë për integrimin e këtyre të fundit në FSK.

## Këshilli i Sigurisë së Kosovës


Sa i përket përbërjes së Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK), në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 127), ky organ duhet të ketë së paku një anëtar nga minoritetet etnike në Kosovë. Anëtarët e KSK-së janë: Kryeministri (i cili kryeson KSK), Zëvendës Kryeministri, Ministri i MFSK-së, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ministri i Punëve të Brendshme, dhe Ministri për Kthim dhe Komunitete, në pajtim me Ligjin për KSK-së (Nr 03/L-050) (QKSS, 2008:5). Gjithashtu, KSK mbështetet nga Sekretariati, Qendra e Situatës, dhe Komitetit të Inteligjencës. Stafi i Sekretariatit është propozuar nga sekretari dhe miratuar nga KSK. **Rregullorja Nr 01/2009 për Organizimin dhe Punën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës** i miratuar në 28 janar 2009, nuk parashihet përshfijjen e anëtarëve të minoriteteve etnike në mënyrë eksplicite, por pritet që të paktën një anëtar nga një grup etnik minoritar në Kosovë të jetë i përfshirë, sidomos në rastet kur kur flitet për të drejtat dhe përfshirjen e tyre në sektorin e sigurisë (Rregullorja Nr 01/2009:Art 4).

## PERCEPTIMI I KOMUNITETEVE PAKICË NË INSTITUCIONET KOSOVARE TË SIGURISË

### Perceptimet: Policia e Kosovës

Ndërveprimi i minoriteteve etnike me institucionet përkatëse gjithmonë ka tendencë që në menyrë automatike të përkthehet në nivel besueshmërie dhe kënaqshmëri më të madhe në raport me atë institucion. Rezultatete fundit të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) tregojnë se rreth 50.33% e Serbëve në Kosovë bashkëpunojnë me PK-në në baza rregullta, ndërkohë që edhe rreth 40.10% të tjerë kanë deklaruar se kanë pasur kontakte me policinë. Aktualisht bashkëpunimi mes PK-së dhe grupeve etnike minoritare duket të jetë shumë më mirë se bashkëpunimi i tyre me komunitetin shumicë Shqiptarë të Kosovës, siç edhe tregohet në figurën më poshtë. Fakti se PK-ja ka një përfaqësim të duhur të pakicave etnike, veçanërisht në zonat dhe komunat ku minoritetet etnike përbëjnë shumicën, ka rritur nivelin e bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve të policisë.

Figura 1 Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës në bazë të Etnicitetit



Megjithatë, tendenca gati e kundërt shfaqet kur analizohet kënaqshmëria dhe besimi ndaj PK-së. Anëtarët e komunitetit Serb kanë një perceptim neutral kur u pyetën nëse atabesojnë në PK. Me konkretisht rreth vetëm 27.90% e tyre janë përgjigjur pozitivisht, ndërkohë që 51.61% grupet e tjera minoritare besojnë në PK. Niveli i mosbesimit ndaj PK-së është mjaft i lartë në mesin e Serbëve të Kosovës, pothuajse 47% e të anketuarve nuk i besojnë këtij institucioni, ndërsa grupet tjera minoritare janë përgjigjur negativisht me 19.35%. Kur u pyetën për nivelin e kënaqësisë ndaj PK-së, më shumë se 29% e komunitetit Serb të Kosovës patën perceptime negativ, ndërsa edhe rreth 26% e të anketuarve nga grupet tjera minoritare në Kosovë duket të jenë të pakënaqur me PK.

Figura 2 Kënaqshmëria me Policinë e Kosovës në bazë të Etnicitetit






Figura 3 Besueshmëria në Policinë e Kosovës në bazë të Etnicitetit



## Perceptimet: Forca e Sigurisë së Kosovës

Rezultatet e fundit të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) tregojnë se rreth 80%-90% e popullsisë së Kosovës në përgjithësi (Shqiptarët, Serbët dhe minoritetet tjera) kanë rralë herë kontakte të drejtpërdrejta me FSK-në. Kjo pasi që ndryshe nga PK, FSK paraqet një natyrë të ndryshme të institucionit të sigurisë, gjë që rezultojnë në bashkëpunimi në baza jo të rregullta në mes të qytetarve dhe FSK-së.

Figura 4 Bashkëpunimi me Forcën e Sigurisë së Kosovës në bazë të etnicitetit



Po ashtu për dallim nga PK, FSK-ja nuk duket të ketë ndonjë reputacion të mirë në mesin e komunitetit Serb në Kosovë. Siç tregohet në figurën e mëposhtme, shumica e Serbëve në Kosovë ose nuk janë fare të kënaqur (25%) me punën e FSK –së, ose nuk kanë fare opinion (61.60%) për këtë institucion, ndërkohë që 64,60 % e grupeve të tjera minoritare në Kosovë janë shprehur të kënaqur me FSK-në. Duket qartë se komuniteti Serb në Kosovë ka qenë i ndikuar nga situata aktuale politike, si dhe presionit të vazhdueshëm si nga nga jashtë (nga zyrtarët e Beogradit) po ashtu dhe nga brendsha (respektivisht nga elitat e tyre të brendshme). Madje, kur janë pyetur për besimin ndaj FSK-së, shumica (77.48 % të Serbëve dhe 58,60% e grupeve të tjera minoritare) e responentëve nga grupet etnike minoritare kishin refuzuar të japin ndonjë përgjigje.

Gjetjet e Barometrit Kosovare të Sigurisë (BKS) tregojnë se vetëm rreth 20 % e serbëve u deklaruan se janë të kënaqur me punën që FSK-ja është duke bërë në Kosovë (QKSS, 2013:3). Ndërsa, kjo kënaqshmëri e ulët me punën e FSK-së kryesisht shpjegohet me dikotominë UÇK – FSK për të cilin është folur në seksionet lartë.

Figura 5 Kënaqshmëria me Forcën e Sigurisë së Kosovës në bazë të Etnicitetit





Figura 6 Besueshmëria me Forcën e Sigurisë së Kosovës në bazë të Etnicitetit



## KONKLUZION

Sektorin e sigurisë në Kosovë megjithëse gjendet në fazën e fillimit të tij, menjëherë ka nisur procesin e RSS me qëllim të përmbushjes së aspiratave të vendit për integrimin euro-atlantik. Në këtë drejtim, **përfshirja e plotë e minoriteteve** etnike në sektorin e sigurisë në Kosovë ka qenë objektivë sfiduese jo vetëm për institucionet vendore, por edhe për komunitetin ndërkombëtar. Është e qartë, megjithatë, se në këtë drejtim secili institucion i sigurisë ka shënuar progres.

Integrimi i plotë i pakicave etnike është një nga parakushtet për krijimin e një sektori të qëndrueshëm të sigurisë në Kosovë, që do të thotë se të gjitha grupet etnike në Kosovë duhet të jenë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të integruara në strukturat e sigurisë (Qehaja dhe Vrajolli, 2012:76-77). Korniza ligjore në Kosovë siguron dhe garanton përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të minoriteteve etnike në të gjitha institucionet publike, duke përfshirë edhe sektorin e sigurisë është tashmë e hartuar, por duhet të ketë një zbatim më efikas dhe më të mirë të ligjeve përkatëse.

Përveç përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht të OKB-së dhe BE-së, për të promovuar dhe afirmuar karakterin multi-etnik të sektorit të sigurisë në Kosovë, ende ka hapsirë për progres nga ana e institucionet vendore. Kapacitetet aktuale administrative dhe të infrastrukturës për minoritetet etnike në sektorin e sigurisë në Kosovë janë konsoliduar dhe forcuar si rezultat i vëmendjes së vazhdueshme dhe mbështetjes në këtë drejtim. Përderisa PK-ja është mbështetur fuqimisht nga donatorë të mëdhenj në promovimin e të drejtave të minoriteteve, edhe FSK është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga ana e NATO-s, në rritjen e ekspertizës dhe paisje teknike, si dhe në inkurajimin e minoriteteve për t'u bashkuar me FSK.

Megjithatë, përfshirja e minoriteteve në sektorin e sigurisë nuk është vetëm një proces brendshëm, pra shpesh ky proces është shumë i ndikuar nga faktorë të tjerë të jashtëm. Ky element është vënë re shumë kur bëhet fjalë për integrimin e plotë të komunitetit Serb brenda sektorit të sigurisë në Kosovë. Presionet e vazhdueshme politike si dhe presionet e jashtme mbi Serbët që jetojnë në Kosovë kanë ndikuar që hezitimi për tu bashkuar me institucionet e Kosovës të rritet vazhdimisht. Dialogu Prishtinë-Beograd premtan se rezultatet e saj do të kontribuojnë në përfshirjen e komunitetit Serb në sektorin e sigurisë, sidomos në FSK. Megjithatë, më shumë vëmendje duhet kushtuar grupeve të tjera etnike në Kosovë dhe të cilat shumë shpesh janë duke u lënë anash. Përfaqësimi i komunitetit RAE është shumë e ulët kryesisht për shkak të nivelit të ulët të edukimit dhe mungesa e informacionit, i cili është konsideruar të jetë një nga faktorët kryesorë sfiduese për këto grupe.

Marrëveshja e Brukselit e nënshkruar në prill 2013 në mes të Kosovës dhe Serbisë shënon një hap të ri drejt integritit të minoritetit Serb në pjesën veriore të Kosovës-veçanërisht integrimin e tyre në strukturat e sigurisë. Fillimi i integritit të ish-pjesëtarëve të MUP-it në pjesën veriore të Kosovës shënon hapat fillestare të trajtimit në nivel institucional të çështjevetë sigurisë në veri. Sa i përket FSK-së, kjo forcë është vazhdimisht duke bashkëpunuar me organet e tjera qeveritare për të siguruar përfshirjen e minoriteteve në mënyrë që të përmbushë kriteret për anëtarësim në NATO. Megjithatë, bisedimet e nivelit të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk kanë prodhuar asnjë marrëveshje që do të ndikojë Serbët e Kosovës për t'u integruar në FSKnë të ardhmen.

---

## REKOMANDIME

---

**Policia e Kosovës** duhet të krijojë ekipe mobile për të informuar dhe për t'u qasur grupeve etnike minoritare, veçanërisht Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

**Policia e Kosovës** duhet të sigurohet që procesi aktual i integritit i anëtarëve të strukturave paralele t'i nënshtrohet në mënyrë rigoroze procesit të verifikimit në mënyrë që të sigurohet që asnjë element kriminal nuk do të inkorporohet në kuadër të strukturës së Policisë.

**Forca e Sigurisë e Kosovës** duhet të organizojë kurse të detyrueshme gjuhësore (Shqip dhe Serbisht) për të garantuar komunikim të mirë të Shqiptarëve dhe Serb edhe në raste të operacioneve komplekse.

**Elita Serbe** duhet të inkurajojë komunitetin serb për të marrë pjesë në FSK. Marrëveshjet e fundit kanë vendosur një pikë në fushën e integritit të komunitetit serb, kështu që elita serbe duhet të jap kontributin e tyre dhe të llobojnë për përfshirje më të mirë në FSK.

**Bashkësia Ndërkombëtare** duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të bindur Serbinë që të mos ndikojnë negativisht mbi Serbët në Kosovë, e të mos ketë qasje antagomiste në lidhje me institucionet e sigurisë në Kosovë, veçanërisht në FSK.



## ANEKSET

### A. KONVENTAT NDËRKOMBËTAR PËR FORCAT E ARTMATORUSA USHTARAKE

TABELA 6: KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MBI FORCAT E ARMATOSURA USHTARAKE (OSBE/ODIHR, 2008)	
<b>Dispozita e Barazisë dhe jo-diskriminimit në disa prej Traktateve për të Drejtat të Njeriut</b>	
<b>Neni. 2 UDHR</b>	Të gjithë kanë të drejtë të gëzojnë gjitha të drejtat dhe liritë e parashtuara në këtë Deklaratë, pa asnjë dallim, të tilla si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik, origjina kombëtare a shoqërore, pasuria, lindja apo statusiti të ndryshëm.
<b>Neni. 26 ICCPR</b>	Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë nga ligji pa asnjë diskriminim. Në këtë drejtim, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë të gjithë njerëzve mbrojtje të barabartë dhe efektive kundër diskriminimit të bazuar në shkaqe të tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinioni politik ose tjetër, origjinë kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose statusi tjetër.
<b>Neni. 27 ICCPR</b>	Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, personat që u përkasin pakicave të tilla nuk duhet t'u merret e drejta, që bashkë me anëtarët e tjerë të grupit të tyre, të gëzojnë kulturën e tyre, të shfaqin dhe praktikojnë fenë e tyre, ose të përdorin gjuhën e tyre.
<b>Neni. 14 ECHR</b>	Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet pa diskriminim në çfarëdo baze të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinioni politik apo tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindjes ose tjetër.
<b>Neni. 1 of Protocol 12 të ECHR</b>	1. Gëzimi i çdo të drejtë të përcaktuar me ligj duhet të sigurohet pa diskriminim të asnjë lloji të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinioni politik ose tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.  2. Askush nuk mund të diskriminohet nga një autoritet publik në çfarëdo baze të tilla si ato të përmendura në paragrafin 1

## B. LIGJET NË SEKTORIN E SIGURISË QË RRJEDHIN NGA KUSHTETUTA TË MIRATUARA NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

<b>TABELA 7:</b>	<b>LIGJET NË SEKTORIN E SIGURISË QË RRJEDHIN NGA KUSHTETUTA E TË MIRATUARA NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b>
<b>Të Aprovuara më 20Shkurt 2008:</b>	
1. Ligji për Policinë	
2. Ligji për Inspektoratin Policor	
<b>Të Aprovuara më 13 Mars 2008</b>	
3. Ligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë	
4. Ligji për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës	
<b>Të Aprovuara më 21Maj 2008</b>	
5. Ligji për Agjencionin e Kosovës për Inteligjencë	
<b>Të Aprovuara më 13 Qershor 2008:</b>	
6. Ligji për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës	
7. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës	
8. Ligji për nryshimin e Ligjit Nr. 03/L- 046 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës	

---

## BIBLIOGRAFIA

---

### Korniza ligjore

- Ahtisaari, M. (2008). Propozimi Gjithëpërfshirës i Përfaqësuesit Special të OKB-së për Kosovën. Nju Jork, OKB.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008). Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
- Ligji Kundër Diskriminimit 2004/3 (2004). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Ligji për 03/L-050 Këshillit të Sigurisë së Kosovës. (2008). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës 03/L-046 (2008). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë 03/L-047 (2008). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Ligji për Përdorimin e Gjuhëve 02/L-37 (2007). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Ligji për Policinë e Kosovës 03/L-035 (2008). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Ligji për Shërbimin në FSK 03/L-08 (2008). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Ligji për të Këshilline Sigurisë së Kosovës 03/L-050 (2008). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës .
- Ligji për Vetë - Qeverisje Lokale 03/L-049 (2008). Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Rregullorja Nr 01/2009 për Organizimin dhe Punën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës (2009) Prishtinë: Qeveria e Kosovës .

## Reportet dhe Publikime

Bassuener, K. dhe Eeber, B. (2013). Dokumenti për Politika i KPD: Ende nuk është bërë asnjë marrëveshje. Kosova dhe Marrëveshja Prishtinë- Beograd. Berlin:KPD.

Blis, D. dhe Qehaja, F. (2013). Kompleksiteti i pronësisë lokale në zhvillimin e sektorit të sigurisë: Rasti i Kosovës. Në Balkan Politic, fq 1-21 .

EULEX Raporti për Programet (2009).

FSK. ( 2012) .Raporti Vjetor 2012. Prishtinë: FSK.

FSK.( 2010). Ngritja - Sfidat dhe Suksesi. Prishtinë: FSK.

GNK (2011). Veriu i Kosovës: Sovraniteti i Dyfishtë në Praktikë. Grupi Ndërkombëtar i Krizave.

GNK (2012).Lirimi i Kosovës: Sfidat e Mbetura .Grupi Ndërkombëtar i Krizave.

GNK(2009).Raporti Evropian.

Greene , M. Friedman, J. dhe Bennet, R. (2012). Ndërtimi I Shërbimit Policor në një vakum të Sigurisë: Përpjekjet Ndërkombëtare në Kosovë, 1999 - 2011. SHBA: Universiteti Princetoën .

KE (2013). Raporti i Progresit për Kosovën 2013. Bashkimi Evropian.

KEDNJ (1966).Konventa Evropiane për të Drejtat Civile dhe Politike.Këshilli i Evropës.

KNDCP (1966).Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Nju Jork: Kombet e Bashkuara.

Kronika e KFOR (2014 ). KFOR.

Lichnofsky, C. (2013). Ashkalinjtë dhe Egjiptasit në Kosovë: Identifikime të Reja Etnike, si Rezultat i Përrjashtimit Nacionalistgjatë Dhunës nga 1990 deri 2010. Artikulli shkencor ditar nga Studime Rome, Vol . 23, Nr 1 .

OSBE (2012).Gjendja e Institucioneve në Kosovës e pas-pavarësisë. Prishtin: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

OSBE. (2009). Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal.Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

OSBE/ODIHR.(2008). Doracak për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Personelit të Forcave të Armatosura. Varshavë: Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).

Pres, K. (2013). Integrimi i MUP-it Serb në Zhvillim e Sipër. 30 janar 2014, Kosovës Press: <http://www.kosovapress.com/en/security/former-mup-members-integration-into-kp-underëay-7398/>

Qehaja , R., Ferati , H., Kosumi , K., & Qehaja, F. (2008). Themelimi, operacionalizimi dhe funksionimi demokratik i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë .

Qehaja, F. ( 2013). Konteksti i zhvillimit të Rishikimit.Strategjik të Sektorit të Sigurisë- Perspektiva e Shoqërisë Civile. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë .

Qehaja, F. dhe Vrajolli, M. (2012). Almanac për Mbikëqyrjen e Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Beograd: Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë.

Qehaja, F. dhe Vrajolli, M. (2012). Monitorimi dhe Vlerësimi i Qeverisjes së Mirë në Sektorin e Sigurisë në Kosovë. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Qehaja, F. dhe Vrajolli, M. (2012). Monitorimi dhe Vlerësimi i Qeverisjes së mirë në Sektorin e Sigurisë së Kosovës. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë .

Qehaja, F.(2008).Vlerësim i Rëndësisë së Këshillit të Sigurisë së Kosovës në Sektorin e Sigurisë. Prishtinë:Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

QKSS dhe FIQ (2011).“Forca e sigurisë së Kosovës, mes sfidave aktuale dhe vizionit për të ardhmen”. Prishtinë: QKSS &FIQ .

QKSS.(2013). Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i tretë. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

RBSS.( 2006). Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë. Kosovë: RBSS.

Stevens, G. ( 2008). Mbushja e Vakumit: Sigurimi i Mbrojtjes dhe Mjetet Juridike për Minoritetet në Kosovë. Prishtinë: Grupi Ndërkombëtar për të drejtat e Minoriteteve.

UDHR. ( 1948) . Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut . Uniten Nation .

## Intervista

Fokus Grup I, (2013, 24 nëntor).Përfshirja e Minoriteteve në Sektorin e Sigurisë. (D. Emini, Intervistuesi)

Fokus Grup II, (2014, 30 janar). Përfshirja e Minoriteteve në Sektorin e Sigurisë. (D. Emini, Intervistuesi)

FokusGrup III, (2014, 23 janar), Përfshirja e Minoriteteve në Sektorin e Sigurisë (D.Emini, Intervistuesi)

Intervistë me Zyrtarët e Policisë së Kosovës (2014, 18 shkurt). Përfshirja e Minoriteteve në Kuadër të PK-së ( D. Emini , Intervistuesi )

Muharremi, Sh. (2014 , 30 janar). Ndihma e OSBE-së për PK (D. Emini, Intervistuesi)

Syla, S. (2014 , 13 janar ). Përfshirja e Minoriteteve në Kuadër të FSK-së. (D. Emini,Intervistuesi)



---

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)